


ARTIKULLI #4

AKTIVITETI I RI I USAID NË KOSOVË MBAN PUNËTORI PËR BASHKËPUNIM STRATEGJIK INDUSTRI-UNIVERSITET

[MAY 2, 2023]

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në link:

<https://drive.google.com/drive/folders/1gcrVOKM1utnDXn4vuvoOzVpFoxUaJgen>




Aktiviteti Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë së fundmi përmbylli sesionin e dytë të punëtorive, të fokusuar në bashkëpunimin strategjik industri-universitet. Ky aktivitet është mbështetur nga USAID dhe i zbatuar nga Universiteti i Iowa në partneritet me Universitetin Shtetëror të Iowa dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).

Udhëhequr nga Daniel L. Clay, dekan dhe profesor nga Kolegji i Edukimit të Universitetit të Iowa, punëtoritë bënë bashkë përfaqësues nga kompani të sektorit privat, borde industriale, profesorë, qendra të karrierës, dhe institucione kërkimore.

Këto punëtori shërbyen si katalizator për planifikim të veprimeve të menjëhershme për të forcuar bashkëpunimet mes bizneseve dhe universiteteve, që shkojnë në përfitim të studentëve

dhe lehtësimi të hyrjes së tyre në tregjet e punës së bujqësisë dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK). Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime rreth sfidave dhe praktikave më të mira për bashkëpunime që u mundësojnë bizneseve të përfitojnë nga kapacitetet kërkimore të universiteteve dhe të marrin studentë të talentuar dhe të motivuar.

Duke mbuluar një gamë të gjerë të temave që ndërlidhen me akademinë dhe partneriteteve me sektorin privat, punëtoritë adresuan praktika, operacione, përfitime, kanale të komunikimit, dhe faza të ndryshme të bashkëpunimit. Ato gjithashtu ofruan një pasqyrë të aktivitetit Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë, duke theksuar rolin e tij në forcimin e sistemeve bashkëpunuese mes universiteteve dhe sektorit privat.



Punëtoritë detajuan përfitimet e shumta që universitetet dhe bizneset mund të nxjerrin përmes krijimit të partneriteteve me njëri tjetrin. Ato mbuluan funksione shumëdimensionale të bordeve industriale në universitete, duke ofruar krahasime informuese me praktikat aktuale në vende si SHBA, si dhe në institucionet partnere si Universitetet e Pejës, Prishtinës, dhe Prizrenit.


Bordet industriale luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e komunikimit efektiv mes akademisë dhe sektorit privat. Të administruara nga universiteti, këto borde sjellin së bashku përfaqësues nga bizneset, institucionet kërkimore, dhe stafi universitar, përfshirë dekanët e fakulteteve, profesorë, përfaqësues studentor, dhe alumni.

Këto borde shërbejnë si platforma dinamike për bizneset që të shprehin nevojat e tyre për resurse njerëzore, kërkesa për njohuri teknike, dhe, kur është e nevojshme, interesin e tyre për t'iu qasur pajisjeve dhe infrastrukturës universitare. Në të njëjtën kohë, universitetet në mënyrë aktive kërkojnë mundësi për mësimnxënie me përvojë, ligjërues ekspertë të ftuar nga industria, vizita studimore, dhe shfrytëzim bashkëpunues të hapësirave më moderne biznesore për qëllime kërkimore dhe arsimore.

Gjatë punëtorisë, pjesëmarrësve u ofruan informata mbi llojet e ndryshme të marrëveshjeve të cilat bizneset dhe universitetet mund t'i krijojnë përmes bordeve industriale. Këto marrëveshje shërbejnë për të definuar përgjegjësitë dhe zotimet respektive të të gjitha palëve të përfshira. Varësisht nga nevojat dhe preferencat specifike të akterëve, këto marrëveshje mund të jenë obligative ose jo-obligative.

Pjesëmarrësit u angazhuan në disa ushtrime grupore me qëllim të identifikimit të mundësive premtuese për bashkëpunime mes institucioneve të tyre. Një sygjërim që doli ishte nevoja thelbësore për të mbështetur studentët në krijimin e profileve gjithëpërfshirëse online, duke u mundësuar bizneseve të sektorit privat të rishikojnë profilet e tyre, dhe më pas të ofrojnë mundësi të punës praktike të personalizuar për aftësitë dhe interesat e tyre. Një sygjërim tjetër, i ngritur nga përfaqësues nga sektori privat i bujqësisë, theksoi nevojën për fuqi të aftë punëtore dhe ekspertizë në fusha si siguria e ushqimit dhe shërbime për kontroll të cilësisë.

Këto informata inkurajojnë universitetet për të menduar zgjerimin e kurrikulave të tyre që edhe më shumë të inkorporohen këto fusha të studimit.



Sesion i punëtorisë hibride mbi bashkëpunimin strategjik universitet-industri, ku pjesëmarrësit morrën pjesë si fizikisht ashtu edhe virtualisht.

"Punëtorja ofroi një mundësi të vlefshme për të forcuar kuptimin tonë mbi atë se si bordet industriale në universitetin tonë mund të forcojnë partneritetet e tyre me sektorin privat. Kishim mundësinë të eksplorojmë fusha potenciale për zgjerim të rrjetit tonë të partnerëve nga sektori privat dhe të angazhohemi në diskutime mbi definimin e përgjegjësive të qarta dhe sistemeve efikase administrative brenda bordit industrial. Këto masa janë thelbësore për nxitjen e bashkëpunimit të rrjedhshëm në të adhmën, dhe për të maksimizuar përfitimet e

bashkëpunimeve tona."

Arbnore Nuha, Zyrtare për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Universiteti i Pejës.

Këto punëtori kanë vendosur një bazë solide për përpjekje të vazhdueshme në nxitjen e marrëdhënieve domethënëse mes universiteteve dhe sektorit privat, të cilat shkojnë në të mirë të studentëve, promovimit të përpjekjeve kërkimore, dhe shtytjes përpara të inovacionit në sektorët e bujqësisë dhe TIK.